

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i përgjithshëm, Gjyqtari Kujtim Krasniqi, me zyrtaren ligjore Dafina Ymeri, në çështjen penale kundër të pandehurit, K.Sh.nga P., për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e Urdhërit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, të Prokurorisë Themelore në Prishtinë / Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr. 4053/2017, të datës 07.11.2017, jashtëseancës, me datë 13.03.2018, morikëtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr. 4053/2017, të datës 07.11.2017, përshqiptimin e urdhërit ndëshkimor,

Andaj gjykata konform nenit 495 të KPPK-së, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

Iakuzuari;

K.G., nga i ati F., i lindur më ..., me vendbanim në P., në rrugën "F.H." p.n. me nr.personal ..., Shqipëtar – shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Më datë 30.06.2017, rreth orës 08:50 min, në rrugën e "U." në P., i pandehuri K.Sh., derisa ka qenë duke drejtuar motoçikletën e tipit "Honda" me ngjyrë të kuqe pa targa, ka vepruar në kundërshtim me nenin 149.1 të Ligjit mbi rregullat e Trafikut Rrugor dhe ka rrezikuar jetën e njerzeve, në atë mënyrë që në vendkalimin për këmbësor në shiritin e djathtë, nuk ka pasur kujdes të duhur ndaj pjesmarrësve të tjerë në komunikacion në këtë rast ka qenë duke kaluar rrugën në vendkalimin e destinuar për këmbësor, me ç'rast i dëmtuari pëson ndrydhje të regjionit iJOR, kombikut dhe kërcirit të majtë të shkaktuara nga veprimi mekanik i mejtit të fortë mbretës, që si të tilla kualifikohen si lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin

Me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform neneve 4, 41, 43, 46, 73 të KPK, si dhe neneve 365 e 495, të KPPK-së i shqipton:

DËNIMIN ME GJOBË

Në shumë prej **200 (dyqind) Euro**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prere të këtij aktgjykimi.

Dënimin e shqiptuar i pandehuri mundë ta paguajë deri në 2 (dy) këste mujore në afat kohor prej 2 (dy) muaj, por jo më shumë se 2 (dy) muaj nga dita e marrjes së formës së prere e këtij aktgjykimi.

Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin e shqiptuar, gjykata mundësinë e pagesës me këste do ta revokoj dhe konform nenit 46 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi **duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro me 1 (një) ditë burg.**

Obligohet: i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe në emër të paushallit gjyqësor, gjykatës t'ia kompenzojnë shumën prej 40.88 euro në emër të ekspertizës së komunikacionit, 20 euro në emër të ekspertizës mjeko-ligjore dhe 30 euro në emër të paushallit gjyqësor, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me detyrim.

Edëmtuara:A.M., me vendbanim në Rr. "I.K." p.n P.,lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinëka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.4053/2017, tëdatës 07.11.2017,kundër të akuzuarit K.Sh.nga P.,për shkak të veprës penaleRrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykatës i është propozuar që kundër të akuzuarit të lëshoj Urdhërin Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës së Prokurorisë në drejtim të vërtetimit të fakteve sei akuzuari vërtetë e ka kryer veprën penalepër të cilën akuzohet.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 493 të KPPK-së Gjyqtari i vetëm gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPK-së dhe mori vendim që ta pranoj kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si:deklaratat e të dëmtuarit-dëshmitaritdeklarata e të pandehurit, mendimi i ekspertësë komunikacionit Kimete Gashi të dt.29.07.2017, mendimi i ekspertit mjeko-ligjor Dr. F.B. i dt.20.07.2017, si dhe fotodokumentacioni, skica të cilat gjenden në shkresat e lëndës, vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale në datë, kohë, vend si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Andaj Gjykata duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elementet e veprës penaleRrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, për këtë edhe i'u shqiptoi urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, u mor konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së, pala e dëmtuar janë udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i përgjithshëm-Penal

P.nr.5183/17, të dt. 13.03.2018

Zyrtare ligjore,
Dafina Ymeri

Gjyqtari,
Kujtim Krasniqi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga marrja e të njëjtit, kësaj Gjykate,pas kalimit të afatit për kundërshtimurdhri ndëshkimor, merr formën e prerë.